KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË PASAGJERËVE NGA AKSIDENTET NË SEKTORIN E TRANSPORTIT PUBLIK

Kjo kontratë është hartuar në zbatim të Ligjit Nr.10076, datë 12.02.2009 dhe Ligjit Nr. 10455 datë 21.07.201, Rregullore e AMF Nr.53datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit".

1.PËRKUFIZIME

1.1.**"Siguresi"** shoqëria e sigurimeve **"ANSIG" SH.A.**

1.2.**"I Siguruari"**, është Personi fizik ose juridik i liçensuar për kryerjen e veprimtarisë së transportit publik nga autoriteti përkatës shqiptar,me cilësinë e pronarit ose përdoruesit mbi mjetet e transportit me të cilat ushtron këtë veprimtari.

1.3.**"Përfaqësues ose Kontraktues"** është personi që kryen veprime dhe nënshkruan kontratën e sigurimit në emër për llogari të të Siguruarit.

1.4.**Mjet Transporti** sipas kësaj kontratë janë të gjitha llojet e tipet e mjeteve që përdoren për transportin publik me pagesë të pasagjerëve, përfshi edhe mjetet e transportit të punetoreve ose turisteve si, mjetet motorrike që lëvizin në toke por jo mbi shina, avioni, mjetet lundruese me ose pa motorr, teleferikët, si dhe të gjitha mjetet e transportit të pasagjerëve mbi shina.

1.5.**Pasagjerë** janë personat që udhëtojnë në mjetet e transportit publik, pavarësisht nëse janë pajisur me biletë udhëtimi ose jo. Konsiderohen të tillë edhe personat që ndodhen në territoret e Stacioneve të mjeteve të transportit publik (të autobuzit, molit, aeroportit), ose pranë mjetit të transportit publik me qëllim për të udhëtuar ose që sapo kanë zbritur nga këto mjete, përveç personelit të punësuar në mjetin e transportit.

1.6.**Aksident** sipas kësaj kontratë do të konsiderohen ngjarjet e papritura, të paparashikuara, të dhunshme dhe të verifikueshme që ndodhin përgjatë përdorimit të mjetit të transportit **publik të pasagjerëve** dhe shkaktojnë vdekje ose paaftësi të përhershme të pasagjerit.

1.7.Akt terrorizmi konsiderohet një veprim, përfshirë por pa u kufizuarnë përdorimin e forcës ose dhunës dhe/ose përpjekjeve për kryerjen e tyre të çdo personi ose grupi personash nëse veprojnë vetëm ose në emër ose në lidhje me çdo organizate ose qeveri, të kryera nxitur nga qëllime politike, fetare, ideologjike ose etnike me qëllim që të ndikojnë veprimtarinë e qeverisë dhe/ose të vënë nën frikë shoqërinë civile ose pjesë të saj;

2.OBJEKTI I SIGURIMIT

Siguruesi mbulon përgjegjësinë ligjore të pronarit të mjetit të transportit publik të pasagjerëve me cilësinë e të Siguruarit, kur ai është përgjegjës për aksidentet që rezultojnë me vdekje ose paaftësi të përhershme të pasagjerëve gjatë përdorimit të mjetit të transportit publik që nuk mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit të mjetit, përkundrejt pagimit të primit të sigurimit.

3.VLEFSHMËRIA TERRITORIALE, AFATI I SIGURIMIT, RINOVIMI, ANULLIMI I KONTRATËS.

3.1.Kontrata për sigurimin e detyrueshëm të pasagjerëve që përdor mjetet publike të transportit mbulon pasojat e aksidenteve të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshi ujrat territoriale dhe hapësiren ajrore të Republikës së Shqipërisë.

3.2.Si rregull kontrata e sigurimit për mbulimin e aksidenteve të pasagjerit lëshohet me afat një vjeçar.

3.3.Ajo hyn në fuqi jo me heret se ora 24.00 e datës së lëshimit të policës së sigurimit kur kjo datë përcaktohet në policë si fillimi i periudhës së sigurimit ose ora 00.00 e çdo datë tjetër të mëvonshme prej datës së lëshimit e përcaktuar në policë si fillimi i mbulimit, por me kusht që primi i sigurimit të ketë kaluar paraprakisht në llogarinë e Siguruesit.

3.4.Afati i vlefshmërisë skadon në oren 24.00 të datës së shënuar në policë si afat i përfundimit të saj.

3.5. Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë së pronarit të mjetit të transportit publik nuk rinovohet me heshtje.

3.6.Në çdo rast me mbarimin e afatit ose periudhës së sigurimit të policës në fuqi pronari ose përdoruesi i mjetit të transportit publik detyrohet të pajiset me policën e vlefshme për periudhen e re të sigurimit.

3.7.Palët nënshkruese të kësaj kontratë kanë të drejtë që të heqin dorë nga kontrata, si në rastin kur ajo nuk ka filluar të zbatohet, ashtu edhe kur ajo është efektive, me anë të njoftimit me shkrim të palës tjetër.

3.8.Heqja dorë nga kontrata, pra anullimi i saj bëhet efektiv në mesnaten e ditës së shtatë, duke filluar nga dita e pranimit të njoftimit nga zyra postare, ose enti tjetër i autorizuar për transportin dhe dorëzimin e dokumentave.

3.9.Anullimi ose tërheqja nga kontrata, nuk ka efekt mbi të drejtat dhe detyrimet e palëve, deri në ditën që ajo ishte në fuqi.

3.10.Kontrata e sigurimit të Pasagjerëve nga Aksidentet në transportin publik anullohet edhe në rastin kur mjeti i transportit pushon së ekzistuari ose del nga qarkullimi. Vërtetimi i ketij fakti kryhet me dokument shkresor lëshuar nga enti përkates që administron mjetin e transportit si Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DPSHTR), Rregjistri Shqiptar i Mjeteve Lundruese dhe Agjensia Nacionale e Transportit Ajror (ANTA) dhe/ose kur subjekti fizik ose juridik që kryen aktivitetin e transportit publik pushon së egzistuari, vërtetuar me dokumentin e ç'rregjistrimit lëshuar nga organi liçensues.

3.11.Në rastin kur gjatë periudhës së vlefshmerisë së kontratës ndryshon pronësia ose e drejta e përdorimit mbi mjetin e transportit publik, kontrata e sigurimit mbetet në fuqi deri në përfundim të afatit të vlefshmërisë së saj të shënuar në policë.

3.12. Pronari ose përdoruesi i ri detyrohet të njoftojë Siguruesin për ndryshimin **brenda 8 ditëve, për pasqyrimin e tij në kontratën e sigurimit.**

3.13.Në rast së polica e sigurimit humbet ose bëhet e pa përdorshme, Siguruesi me kërkesën dhe shpenzimet e të Siguruarit lëshon dublikatën e policës në fjalë.

3.14.Kontrata e sigurimit për çdo pasagjer në veçanti është e vlefshme për sa kohë ai (pasagjeri) konsiderohet si i tillë, sipas përcaktimit në nenin 1.1.5, më sipër.

4.SHUMA E SIGURIMIT, PRIMI I SIGURIMIT E KTHIMI I TIJ

4.1.Shuma e Sigurimit ose Përgjegjësia maksimale e Siguruesit përkundrejt çdo pasagjeri me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit shënohet në policën e sigurimit, por nuk mund të jetë më e vogël së **2 milione lek** për rastin e humbjes së jetës dhe **4 milion lek** për paaftësinë e përhershme.

4.2.Pagesa e primit të sigurimit kryhet njëherësh pranë Deges ose agjencise së Siguruesit ku lëshohet Polica e Sigurimit. Pagesa do të quhet e kryer në momentin e kalimit të shumes së caktuar të primit në llogarinë e Siguruesit.

4.3.Primi i sigurimit mund të kthehet vetëm në rastet kur kërkohet anullimi i kontratës, gjatë periudhës së vlefshmërisë së policës së sigurimit, pra mjeti i transportit dhe/ose subjekti fizik ose juridik pushon së egzistuari, ose anullimi i kontratës kerkohet nga i Siguruari. Në çdo rast kthimi i primit është i mundur vetëm nëse vërtetohet që deri në datën e kërkesës për kthim primi, nuk ka patur kerkesa për dëmshpërblim tek Siguruesi, nga palë të treta me cilësinë e pasagjerit.

4.4.Kthimi i primit bëhet i mundur kur Siguruari dorëzon policën origjinale të sigurimit dhe vërteton me dokumente që:

4.4.1.Mjeti i transportit publik ka pushuar së egzistuari dhe ai ka dorëzuar lejen e qarkullimit të mjetit dhe aksesorë të tjerë si targa, etj., tek Autoriteti kompetent shtetëror i administrimit të mjetit të transportit;

4.4.2.Personi fizik ose juridik që kryente aktivitetin e transportit publik ka pushuar së egzistuari me vërtetim nga Autoriteti licensues i pushtetit qendror ose vendor;

4.4.3.Deklaron me shkrim së do të rimbursojë vlerën e çdo dëmshpërblimi që Siguruesi është i detyruar të paguajë lidhur me ketë policë, nga kërkesa të legjitimuara për dëmshpërblim që mund ti drejtohen në të ardhmen Siguruesit.

5.RREZIQET E SIGURUARA, PËRJASHTIME.

5.1.Siguruesi mbulon të gjitha ngjarjet aksidentale, për të cilat i Siguruari me cilësinë e pronarit të mjetit të transportit publik të pasagjerëve cilësohet përgjegjës, të ndodhura përgjatë përdorimit të mjetit dhe që nuk mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm i përgjegjësisë së pronarit të mjetit, të cilat rezultojnë me humbje të jetës ose paaftësi të përhershme të pasagjerit.

5.2.**Siguruesi nuk mbulon dëmet e pësuara nga pasagjeri që:**

5.2.1.Nuk shoqërohen me pasojë vdekje dhe/ose paaftësi të përhershme edhe kur shkaktohen nga një ngjarje e përcaktuar si aksidentale sipas kuptimit të aksidentit dhënë në këtë kontratë; Përcaktohen si dëme materiale, si sendet në pronësi a nëdorësi të tij, bagazhi etj.

5.2.2.Rezultojnë nga aktet terroriste.

5.2.3.Shkaktohen nga veprime luftarake të fuqive ndërluftuese pavarësisht nëse lufta është shpallur ose jo, veprime që shoqerojnë turbullirat civile, rebelimin, kryengritjen ose luften civile;

5.2.4.Shkaktuar nga energjia bërthamore ose radioaktiviteti i çdo lloji

6.DETYRIMET KRYESORE TË PALËVE

I Siguruari ka detyrim:

6.1.Të lidhë kontratë për sigurimin e pasagjerëve që përdorin mjetet e transportit publik;

6.2.Të japë të gjithë informocionin në dijeninë e tij më të mirë tek Siguruesi, për karakteristikat e mjetit/eve të transportit publik që ai disponon dhe natyrën e zakonshme të punës dhe përdorimit të tyre, përpara lëshimit të policës së sigurimit;

6.3.Të njoftojë Siguruesin për të gjitha ndryshimet në ushtrimin e veprimtarisë së transportit publik, që ndodhin përgjatë vlefshmërisë së policës;

6.4.Të paguaje primin e sigurimit dhe të kujdeset për rinovimin e kontratës në afatin e duhur;

Siguruesi ka detyrim:

6.5.Të lidhë kontratën e sigurimit, kur kërkuesi i sigurimit pranon kushtet e paraqitura prej tij, për mbulimin e përgjegjësisë ligjore të Pronarit të mjetit të transportit publik;

6.6.Të trajtojë çdo kerkesë për dëmshpërblim drejtuar atij nga kërkuesi (pasagjeri);

6.7.Të njoftojë palën e dëmtuar ose kërkuesin për masen e përllogaritur të dëmshpërblimit (kur përgjegjësia e tij është vërtetuar);

6.8.Të njoftojë kërkuesin me shkrim nëse refuzon kërkesën për dëmshpërblim, duke përcaktuar shkaqet ligjore që justifikojnë refuzimin;

6.9.Të paguaj për çdo vonesë mbi afatin ligjor për kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit, interesin e pagueshëm mbi shumen e dëmshpërblimit.

7.NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT, KËRKESA PËR DËMSHPËRBLIM DHE PAGESA E DËMIT

7.1.Përgjegjësia, e drejta e dëmshpërblimit dhe shuma e tij, si dhe dokumentet e nevojshëm për përfitimin e dëmshpërblimit përcaktohen në dispozitat e Ligjit Nr. 10076, datë 12.02.2009 "Për Sigurimin e Detyrueshëm në Sektorin e Transportit" kreu i II-të, Akteve nënligjore në zbatim të tij, Rregullores së Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare Nr. 53, datë 25.06.2009 "Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit" dhe kushteve të përgjithshme të kësaj kontratë.

7.2.Pasagjeri i përfshirë në aksident ose përfituesi në rastin kur pasagjeri vdes, për të realizuar të drejten e dëmshpërblimit duhet:

7.2.1.Të njoftojë Siguruesin përgjegjës me shkrim ose në mënyrë elektronike brenda 10 diteve nga ndodhja e aksidentit ose momenti kur kishte mundesi për të dhene njoftimin, duke pershkruar rrethanat në të cilat ndodhi aksidenti si, koha, vendi, shkaku i aksidentit, mjeti/et e transportit të përfshira në aksident etj.;

7.2.2.Të dorëzojë biletën e udhetimit ose çdo dokument tjetër në origjinal që provon së pala e dëmtuar ka qenë pasagjerë, në momentin e ndodhjes së aksidentit;

7.2.3.Të dorëzojë Vendimin e Prokurorisë për ngjarjen dhe/ose Vendimin e formës së prerë të Gjykatës për cilësimin e përgjegjësisë së Pronarit (drejtuesit), të mjetit të transportit publik;

Në rast të ndodhjes së dëmit, i dëmtuari do të plotesojë dok për shperblimin e dëmit në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligj

8.KËRKESA PËR RIMBURSIM

8.1. Kur shoqëria e sigurimit ka paguar përfituesin e palës së dëmtuar në përputhje me ligjin Nr.10076, datë 12.02.2009, ligji Nr.10455 datë 21.07.2011"Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit ",Rregullore Nr.53 datë 25.06.2009 dhe kushteve të kësaj kontratë, por sipas të drejtës së sipërcituar nuk ka qënë përgjegjë se, ka të drejtë të kërkojë rimbursim nga personi përgjegjës për masen e paguar për dëmin, interesat dhe shpenzimet për arkëtimin e tij.

8.1.**Siguruesi nuk është përgjegjës për dëmin kur I Siguruari:**

8.1.1.Nuk përdor mjetin e transportit në pajtim me qëllimin e deklaruar për të cilin është i destinuar të përdoret;

8.1.2.Përdor mjetin e transportit pa patur lejen e drejtimit të kerkuar nga ligji;

8.1.3.Drejton mjetin e transportit nen ndikimin e alkoolit mbi kufijtë e lejuar ose nen ndikimin e lëndeve narkotike ose psikoaktive;

8.1.4.Shkaktonqëllimisht aksidentin;

8.1.5.Kur aksidente ndodh për shkak të defekteve të ndjeshme teknike, për të cilat drejtuesi i mjetit ka qenë ose duhej të ishte në dijeni.

8.1.6.Siguruesi nuk është gjithashtu përgjegjës për dëmin kur mjeti i transportit drejtohej nga një drejtues i pa autorizuar. Drejtues i pautorizuar është personi që në momentin e aksidentit drejton mjetin e transportit pa lejen e pronarit, nuk është punësuar prej tij, nuk është anëtar i familjes së tij dhe nuk e ka marrë mjetin e transportit në dorëzim pre tij.

8.1.7.Siguruesi nuk është përgjegjës kur Vendimi i Gjykatës së formës së prerë shpall përgjegjës për aksidentin një person ndryshe nga I Siguruari.

9.ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Mosmarrëveshjet midis Siguruesit dhe të Siguruarit kur nuk zgjidhen me mirëkuptim zgjidhen nga Gjykata e vendit ku është lidhur Kontrata e Sigurimit.